



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.Shk II.nr.321/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të KOSTT – Operatori, Sistemi, Transmisioni dhe Tregu Sh.A, me numër unik identifikues 811284512 dhe seli në Prishtinë, rr. “Isa Boletini” nr. 39, kundër debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESco) Sh.A., me numër unik identifikues 811288887 dhe seli në Prishtinë, “Bulevardi Bill Klinton”, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2135/22 të datës 12.12.2023, me datë **04.06.2024**, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESco) Sh.A., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2135/22 të datës 12.12.2023, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2135/22 të datës 12.12.2023 ka pranuar pjesërisht si të bazuar propësimin e debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESco) Sh.A., me seli në Prishtinë, ashtu që ka anuluar pjesërisht Urdhrin Përmbartimor P.nr. 376/2022, i lejuar me datë 18.08.2022, nga Përmbartuesi Privat Saranda Rexhepi sa i përket borxhit kryesor në vlerë prej EUR 3,054,994.08 dhe procedura në këtë pjesë të përmbartimit është përfunduar.

Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht propësimin e debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESco) Sh.A., me seli në Prishtinë, ndërsa ka lënë

në fuqi Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 376/2022, i lejuar me datë 18.08.2022, nga Përmbarruesi Privat Saranda Rexhepi, sa i përket kamatës në lartësi prej 4.5% mbi borxhin kryesor si në pikën I të dispozitivit si dhe shpenzimeve të procedurës përmbarrimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2135/22 të datës 12.12.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa e të debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori KOSTT – Operatori, Sistemi, Transmisioni dhe Tregu Sh.A, ka paraqitur propozim për përmbarrim në bazë dokumenteve të besueshme, Faturës nr. 0107, e datës 12.04.2022, si dhe Faturës nr. 090, e datës 13.04.2022, ka lejuar Urdhrin përmbarrimor P.nr. 376/2022, të datës 18.08.2022, me të cilin është urdhëruar debitori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESco) Sh.A., që, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, kreditorit t'ia paguaj borxhin në lartësi prej EUR 3,054,994.08, me kamatë prej 4.5% vjetore, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim përmes së cilit e ka kontestuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbarrimit, me arsyetimin se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarrimi nuk përbëjnë dokument të besueshëm ngase të njëjtat janë dëshmuar të jenë pro-fatura dhe notë debiti dhe notë kredit, dhe se të njëjtat nuk janë të nënshkruara nga ana e debitorit, ashtu që të njëjtat nuk i plotësojnë elementet e një fature e cila do të konsiderohej si dokument i besueshëm. Me te, ka theksuar se këto fatura nuk kanë asnjë dokument mbështetës që do ta vërtetonte valideitetin e faturave, andaj edhe propozimi për përmbarrim nuk i plotëson elementet nga neni 38 të LPP-së. Ndërsa, ka shtuar se kjo çështje i përket natyrës kontestimore ngase mënyra e krijimit të borxhit ndërlidhet me krizën energjetike, dhe se çfarëdo detyrimi që mund të ketë debitori ndaj kreditorit nuk mund të bartë përgjegjësinë për shkak të kësaj krize dhe si pasojë e

rritjes së çmimeve. Prandaj, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigjen e paraqitur ndaj prapësimin të debitorit i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit, ndërsa ka shtuar se urdhri përmbartimor është lejuar mbi bazën e dokumenteve të besueshme, përkatësisht faturave të cilat i përmbajnë të gjitha elementet e dokumentit të përshtatshëm për përmbartim dhe në kuptim të nënti 29, pika 1.3 të LPP-së përbëjnë dokument të besueshëm. Me tej ka theksuar se faturat derivojnë nga marrëveshja mes palëve për blerje të energjisë eklektike nga burimet e ripërtërishme dhe marrëveshja për aderim në rregullat e tregut. Po ashtu, ka theksuar se janë të paqëndrueshme pretendimet e propozimi është paraqitur në kundërshtim me nenin 38 të LPP-së, ngase faturat janë prezantuar në origjinale pranë organit përmbartimor ashtu siç kërkohet me këtë dispozitë. Në fund, ka theksuar se pretendimet se debitori është dëmtuar nga kriza energjetike në vend nuk paraqesin shkak për mos përmbushje të obligimeve. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2135/22 të datës 12.12.2023, ka pranuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESco) Sh.A., me seli në Prishtinë, ashtu që ka anuluar pjesërisht Urdhrin Përmbartimor P.nr. 376/2022, i lejuar me datë 18.08.2022, nga Përmbartuesi Privat Saranda Rexhepi sa i përket borxhit kryesor në vlerë prej EUR 3,054,994.08 dhe procedura në këtë pjesë të përmbartimit është përfunduar. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESco) Sh.A., me seli në Prishtinë, ndërsa ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbartimor P.nr. 376/2022, i lejuar me datë 18.08.2022, nga Përmbartuesi Privat Saranda Rexhepi, sa i përket kamatës në lartësi prej 4.5% mbi borxhin kryesor si në pikën I të dispozitivit si dhe shpenzimeve të procedurës përmbartimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbartimi në vlerë të përgjithshme prej EUR 3,054.994.08, debitori ka përmbushur borxhin andaj, faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbartimi, për shkak të përmbushjes kanë humbur efektin juridik. Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi, duke refuzuar pjesën tjetër të prapësimin dhe duke lënë në fuqi urdhrin përmbartimor sa i përket kërkesës për pagesën e kamatës në lartësi prej 4.5%, pasi që kjo lartësi e kamatës është kontraktuar

nga palët dhe e njejta është pasqyruar në faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbartimore.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori, e të cilat fatura përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshme për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Duke pas parasysh faktin se debitori ka përmbushur në tërësi borxhin sipas faturave mbi të cilat është lejuar urdhri përmbartimor në lartësi prej EUR 3,054,994.08 të cilën nuk e kanë kontestuar palët edhe kjo gjykatë vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që edhe sipas vlerësimit të gjykatës ankimore aktvendimi mbi përfundimin e procedurës ne këtë çështje përmbartimorë është i rregullt dhe ligjor pasi përkitazi për rastin ne fjalë, dispozita e nenit 66 par.4 parasheh qe: *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendim për përfundimin e procedurës përmbartimore”*.

Sa i përket pikës II të dispozitivit edhe kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbartimor sa i përket kamatës në lartësi prej 4.5% mbi borxhin kryesor si dhe shpenzimeve të procedurës përmbartimore meqenëse debitori ka rënë në vonesë në përmbushjen e borxhit kryesor, duke përmbushur borxhin vetëm pas inicimit të procedurës përmbartimore nga ana e kreditorit, në mbështetje të nenin 382.1 të LMD-së

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por te njëjtat mbesin te pabazuara pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht te vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si te tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

**Dhoma e shkallës së dytë**

**K.DH.Sh.II.nr. 321/24, Datë 04.06.2024**

**Gjyqtari,  
Faton Bajrami**